

01-349  
22.06.2020



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
Komuna e Novobërdës  
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës  
Z/znj \_\_\_\_\_

Në bazë të dispozitave te nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si  
dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e tretë e rregullt e Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë:  
**30.06.2020** (e martë) duke filluar në ora 10:00.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-se;
2. Aprovimi i Kornizes Afatmesme Buxhetore (KAB) 2021-2023;
3. Raport nga Komisioni Komunal i Emergencies rrëth menaxhimit të situates së pandemis;
4. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 22.06.2020  
Në: Novobërdë

Nebojsa Arsic  
Kryesues i Kuvendit

H. Arsic





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosova**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo**

**ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE**

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e dytë Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 27.02.2020, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Jorgovanka Filic, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, ZKKK Sami Vllasaliu, përfaqësuesi i OSBE-së dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshtendeti të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë 12 antarë të Kuvendit nga 15 gjithësej, tre antarë mungojn me leje, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

**R e n d d i t e**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i Raportit Financiar të tremujorit të katërt për periudhen kohore Tetor - Dhjetor 2019;
3. Raport nga DSHP rrëth realizimit të rrugës dhe ujësjellësit në fshatin Stanishor;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti antarët e Kuvendit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim? Ramush Mehmeti pasi pershtendeti të pranishmit tha: unë si zv.Kryesues jamë obligativ që të marrë pjesë edhe në mbledhje të komitetit për komunitete dhe në mbledhjen e fundit të komitetei kemi marr vendim që të propozohet edhe njëher plani aksional për riadheshim, Kuvendi në mbledhjet e kaluar nuk i ka votuar këto plane për arsy se nuk kemi pasur listen e perfituresve, pasi që zyrtari Sami Vllasaliu ka marrë për obligim në komitet që të na dergoj listen në Kuvend dhe këtë list na ka derguar listen e qytetarëve perfitures dhe listen e qytetarëve të riadheshuar, prandaj propozoj që për rend ditë të hy edhe kjo pikë, ju faleminderit.

Pasi nuk pati propozime tjera aprovohet rendi i ditës me 11 vota për, 1 apstenim me këtë pikë shtesë të propozuar: Aprovimi i planit për personat e riadheshuar.

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi tha: procesverbalit në gjuhen serbe nuk ka arritur me kohë për arsyet e problemeve teknike por në gjuhen shqipe e keri marrë me kohë, akeni ndonjë diskutim lidhur me procesverbalin.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbalit nga antarët prezent të Kuvendit me 10 vota dhe 2 apstenime.

**Pika e dytë:** Aprovimi i Raportit Financiar të tremujorit të katërt për periudhen kohore Tetor - Dhjetor 2019;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të financave Sercan Todorovic.

## Procesverbal i Kuvendit

Sercan Todorovic pasi pershendetë të pranishmit tha: besoj se materialin e keni marrë me kohë, për këtë tremujor të hyrat gjithësej kanë qenë 40,560.57€ ku përfshihen të hyrat nga tatimi në pronë, nga regjistrimi i automjeteve dhe taksat komunale e të hyrat e tjera. Sa i perket shpenzimeve të mjeteve për paga dhe meditje kanë qenë të planifikuara 475,868.25€ ndërsa janë shpenzuar 474,418.87€ në perqindje 99.69%. Për mallra dhe sherbime dhe sherbime janë shpenzuar 95,216.83€, për shpenzime Komunale janë shpenzuar 11,465.35€, për subvencione janë shpenzuar 5,289.96€, për investime kapitale janë shpenzuar 371,267.70€. Në tabel i keni të paraqitur për secilen Drejtori veç e veç nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmei tha: raporti në gjuhën shqipe dhe serbe ka dallim, në gjuhën shqipe mungojn dy faqet e para nuk e kemi tabelen e të hyrave. Në administrat i kemi paga 1400€ për kënd janë këto paga të kategoria mallra dhe sherbime si dhe shpenzime tjera të kontraktuara mbi 17.000€ çfarë shpenzime bëhet fjalë?. Obligativ jeni më ligj që çdo cent që shpenzohet në si Kuvend duhet ta dim, i kemi shpenzimet e Kryetarit dhe shpenzimet e Kryesuesit për çka janë këto shpenzime pasi që nuk janë të definuara për çka, 484.03€ janë shpenzimet e Kryetarit dhe 255.36€ janë shpenzimet e Kryesuesit. Në dallim nga raportet tjera këtu cekën edhe mjetet e shpenzuara për investime kapitale ku 12.580 janë investime të pa qarta se ku janë shpenzu këto mjete, nga permbaruesi privat janë marrë 9,176.18€ sa mjete janë marrë nga permbaruesi për sherbimin e vet pasi që kur janë terhjek këto mjete kanë mujt me qenë 6000€ ndërsa të tjerat tatim nga permabruesi dhe pyetja e fundit nga kodi i arsimtit fillor janë terhjek 2000€ petikesh më intereson ta dij se ku kan shkuar ato mjete për çka janë perdon?, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: këto dy faqe që po mungojkan në gjuhën shqipe nuk e di arsyen, mundet me qenë gabim teknik, keni pyetur për paga ato janë pagat që janë pagur punëtorët në qendren e regjistrimit të automjeteve, investimet kapitale mundë ti shihni në zyre të prokurimit se çka kemi paguar me ato mjete, skemi pasur kod të veqant dhe janë te regjistruar si mjete tjera, është lënda në zyre të prokurimit ata e kanë derguar fakturen ne vetem e kemi bërë pagesen, mjetet e marrura nga permbaruesi janë për pagat jubilare na kanë padit punëtorët e arsimt, ky problem nuk është vetem në Komunën tonë por në të gjitha Komunat, sa i perket peti-ceshit ju e dini se Kryetari i ka të drejt 5000€ si llogari rrjedhese dhe mundëti merr ti shpenzoj dhe aty ka pas mjete aty i ka marr.

Ramush Mehmeti tha: te kodi për zhvillim ekonomik pershkrimet tjera janë shume mirë si ndertimi i rrugëve lokale, trotuari, kanalizimi, mirëmbajta e ndriqimit por mjetet tjera në vlerë prej 12,580.00€ kjo për herë të parë ka ndodh. Petikesh jo 2000€ por as 200€ nuk kan te drejt të shpenzohen pa u asryetuar se ku janë shpenzuar, nese thuhet se janë shpenzuar 200€ për bilet të autobusit në rregull e jo vetem janë terhjek 2000€ petikesh e mos të dihet se ku janë shpenzuar.

Sercan Todorovic tha: sa i perket petikeshit Kryetari i bjen fakturat dhe ne ato faktura i dergojm në thesar dhe është e caktuar se për çka ka drejt të shpenzohet petikeshin, ne nuk mundemi që çdo faktur ta shkruajm, petikeshin e arsyetojm në thesar.

Ramush Mehmeti tha: shpenzimet e Kryetarit çka janë këto shpenzime?, çka kanë shpenzuar?, shpenzimet e tjera janë cek të gjitha por këtu shkrujn vetem shpenzimet e Kryetarit dhe shpenzimet e Kryesuesit, ne duhet ditur se çka është shpenzuar.

Selatin Nuhiu pasi pershendetë të pranishmit tha: ne në këtë mbledhje e kemi këtë raport financiar se ku po shpenzon Komuna dhe ky raport është gjysmak, raposti në gjuhën shqipe ne nuk e dim se sa ka pas të hyra, të investimet kapitale janë 371,267.70€ janë vetem në tremujorin e katërt, më intereson të dij se a vetem në këtë tremujor ka pas investime kapitale apo ka pasur edhe më herët dhe pyteja tjeter për Drejtorin se a janë perfunduar të gjitha projektet që kanë kaluar në Kuvend, kanalizimi në fshatin Tullarë nuk është perfunduar në lagjen Zenaj që janë ndarë 6000€ si dhe në fshatin Llabjan të Migrosi që janë ndarë 4500€ me intereson të dij se sa janë implementuar investimet kapitale?.

Sercan Todorovic tha: unë nuk di të perkthej, ne e kemi pregaditur në gjuhën serbe dhe e kemi derguar për perkthim, e dyta unë këta numra nuk i shkruaj por sistemi i vendos edhe unë kam deshir që

## Procesverbal i Kuvendit

shpenzimet të janë më të vogla por ky është realiteti. Sa i perket projekteve aty ku sësht kryer sigurisht se nuk ka pasur mjete, ju skeni pas ekspert për projekte, keni catuar një shumë për një projekt si rruga në Makresh 20,000€ ndërsa projekt ka kushtuar 50,000€ dhe projektet realizohen në fund viti pasi që mjetet lëshohen prej Ministrisë në muajin Qershor e pastaj deri sa të fillohet dhe të perfundojn procedurat e tenderimit.

Mirjana Simijonovic pasi pershendetë të pranishmit tha: në këtë raport kemi shumë paqartësi, në sistem zyratërt tuaj i fusin këto të dhëna dhe zyrtarët e din se ku janë shpenzuar këto mjete, permbaruesi po merr mjete çdo tre muaj, ju u deklaruat se nuk i keni planifikuar por nese këto paga jubilare ju takojn më ligj është duhur ti planifikoni më kohë. Edhe në KPF-ë kemi diskutuar se Novobërda është Komuna më e varfër dhe ne jemi zgjedhur për ti mbrojtur interesat e qytetarëv. Nuk e di se a jeni serioz ndaj Kuvendit lidhur me informata që na ofroni, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: këtë problem me pagat jubilare e kanë të gjitha Komunat, Ministria nuk ka lejuar këto mjete dhe unë sipas mundësive që kam ju jap të gjitha informatat që po i kerkoni.

Abdyl Gashi pasi pershendetë të pranishmit tha: më shumë Drejtori po duket si sherbyes civil i cili nuk po arrin me i kontrollu se cili zyrtar merret me shpenzime apo zyrat që shpenzojn paran publike. Te shendetësia primare kemi deriveat 2,559.53€ ndërsa mjete medicionale i kemi 735€ kur e dim se është vetem një vetur ambulant dhe është ne defekt, pyetja tjeter është se a ka punëtor që gjenden në lista të pageve e nuk janë në vend të punës në arsim, shendetësi dhe mendoj se në si Kuvend është mirë të kerkojm listen e pagave për secilin digaster pasi që në të kaluaren kemi parë se ka në listen e pagave punëtor të cilët nuk punojn por marin paga duke qendruar në shtepit e tyre pa punuar fare.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 4 vota për, 8 kunder ( Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Selatin Nuhiu, Jahi zeqiri, Abdyl Gashi, Mirjana Simijonovic, Dragana Dimic, Milica Jovanovic) nuk aprovohet raporti financiar për tremujorin e katërt për vitin 2019.

**Pika e tretë:** Raport nga DSHP rreth realizimit të rrugës dhe ujësjellësit në fshatin Stanishor;

Kryesuesi tha: këto dy pika janë propozim nga Komiteti për Komunitete, Dobrivoje Djordjevic ka kerkuar nga D.SHP që të raportoj rreth kësaj pike por siç duket nuk është prezent.

Dobrivoje Djordjevic pasi pershendetë të pranishmit tha: deshiroj të jap një vërejtje pasi që çdo herë që personat perqejës nuk po vin në mbledhje për të raportuar ne po i shtym këto pika, menodj se duhet të punohet një strategji që ti obligoj këta persona që të marrin pjesë. Ne protesten që kemi organizuar Kryetari ka premtuar se bashku me zv.Ministrin se kjo rrugë do të realizohet. Sa i perket ujësjellësit në fshatin Stanishor në nja takim që Kryetari ka qenë prezent vet na ka premtuar që do të zgjidhet pasi që nuk është larg nga Koretishta. Në këto mbledhje të Kuvendit nuk mundë të realizojm asgjë, Shefkija njëher ka thënë se ajo është rrugë regionale dhe jo lokale atëher duhet ti drejtohem Kompanis pasi që asnjë kompani nuk po e mirëmban atë rrugë.

Kryesuesi tha: ne smund ta detyrojm askend të vij me dhunë, sa i perket rrugës po permendet se është rrugë regionale dhe për këtë arsy nuk janë vendos shenjat për kufizim të shpejtësisë.

Dobrivoje Djordjevic tha: vetem një sygjerim në raport të punës së Kuvendit mundë ta cekni se ky person nuk ka punuar dhe nuk na ka respektuar ne si Kuvend.

Ramush Mehmeti tha: perfaqësuesi i OSBE-së është këtu na monitoron çdo herë dhe po shihet se ku është pengesa. Në bazë të Ligjit për Vetqeverisje Lokale Kryetari është obligativ që të raportoj në Kuvend ndërsa Kryetari yn nuk ka raportuar asnjëherë. Unë i thash edhe më herët Drejtorit të financave se në bazë të Ligjit për financat çdo cent të shpenzuar jeni obligativ ta raportoni e nuk mundë të shpenzoni shuma paushalle pa dhënë llogari. Te rruga në fshatin Stanishor në Drejtori të Sherbimeve Publike janë cek 51,000€ ndertimi i rrugëve lokale, mjetet janë shpenzu por a kan punuar diçka. Ne si Kuvend e kemi ndarë buxhetin aq sa kemi pasur mundësi por probelmi është se tjeter kush është kompetent që ta shpenzoj atë buxhet. Unë mendoj që ne si Kuvend të ngrisim padi ndaj Kryetarit të Komunës, nese në këtë Kuvend është votu ndertimi i rrugës në fshatin Stanishor pse sështë ndertuar rruga, pagesat janë bërë ndërsa punët nuk janë kryer. Raporti i auditorit ka dal raporti më i keq në Kosovë.

## Procesverbali i Kuvendit

Milica Jovanovic pasi pershendetë të pranishmit tha: vetem të nderlidhem me këto veshtersi në fshatin Stanishor, mendoj se këto protesta është duhur ti organizojnë këtu para Komunës dhe ti thirrin mediat.

Mirjana Simijonovic tha: sot në mbledhje kishte qenë mirë që të janë të pranishem më shumë qytetarë, edhe në fshatin Koretishtë kemi pasur problem me ujësjellës, ashtu si e permendu kolegu më herët Drejtoresh e Sherbimeve Publike ka qenë Shefkija por tash kush është?, sigurisht se qytetarët e fshatit Stanishor kanë dorzuar kerkasë dhe mendoj se ata duhet ti vazhdojn protestat, ti thirrin mediat dhe të shohin se në shek XXI nuk ka ujësjellës. Sa i perket rrugës kam qenë vet prezente dhe është premtuar se do të rregullohet ajo rrugë por ditët kalojn dhe ende nuk është bërë asnjë zgjidhje, gjatë dites kalojn 100 kamion në atë vendbanim. Nuk e di se si është e mundur që në Komunën tonë ti kemi 9 gurthyes.

Kryesusi kerkoi pauz 5 min.

Pas pauzes 5 minutshë vazhdoj mbledhja me diskutime.

Selatin Nuhiu tha: e kuqtoj shqetësimin e banorëve të fshatit Stanishor, ne si Kuvend po mundohemi me ju ndihmu me ju bë zgjidhje, ne kemi kerkuar një raport nga DSHP dhe nuk është hera e parë që kerkojm raporte dhe nuk vin që të raportojnë, kemi kerkuar raport nga Drejtoria e Arsimit por nuk na ka ofruar, kemi kerkuar raport nga Drejtoria e Kadatrit por nuk na kan ofruar, kemi kerkuar raport nga Kryetari i cili është obligativ që të raportoj dy herë në vit por nuk po janë pergjegjës ndaj Kuvendit. Sot është duhur të jetë në rend dite edhe raporti i DAK-ut per perfundimin e gjysemvjetorit të parë.

Dobrivoje Djordjevic tha: vetem tju falenderohem kolegve qe këtë problem të qytetarëve të fshatit Stanishor e kan kuptuar seriozisht dhe po më përkrahin.

Kryesuesi tha: pasi nuk ka diskutime tjera kalojna në pikën tjetër që e propozum për rend dite.

**Pika e katërt:** Aprovimi i planit aksional për personat e riadhesuar.

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalen ZKKK Sami Vllasaliut.

Sami Vllasaliu pasi pershendetë të pranishmit tha: është hera e dytë që po e prezantoj këtë plan para jush, ky plan ka të bëjë me personat e riadhesuar. Fillimisht kerkoi që ta bëni dallimin në mes të planit Komunal për kthim dhe planit Komunal për riadhesim pasi që janë dy plane të ndara. Ky është plani për personat që kthehen prej vendeve të treta. Sa i perket numrit të këtyre personave ju kam derguar dhe e keni marrë me material edhe numrin e personave të regjistruar si dhe numrin e perfituesve. Po e ceki edhe njëher se ky plan ka dal nga Strategjia kombëtare për riadhesim në nivel të vendit, kerkoi që ky plan të aprovohet për arsy se këtyre personave ju mundësohet dhënja e një ndihmese siç është rregullimi i dokumentacioneve të ndryshme ndërsa aplikimi për projekte të ndryshme shkon permes zyres komunale të punësimit, prej 82 personave që kemi të regjistruar në sistem si persona të riadhesuar 8 persona kanë perfituar në vitin 2018 dhe 1 persona kanë perfituar në vitin 2019, nuk është edhe numri i vogel në Komunën tonë, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: në seancen e para fundit kam kerkuar që ky plan të mos aprovohet pasi që nuk kemi pasur list të personave perfitues, problemi më i madhë në Komunën tonë është se nuk po raportohet jo vetem për ndertim të shtepive por për shumë projekte, kerkoi nga të gjithë që ta perkrahmi pasi që zyrtari na ka respektuar na ka derguar listen.

Dobrivoje Djordjevic tha: kam obligim të lajmërohem pasi që në komitetin për komunitete jam deklaruar se do ta përkrahi, e kam një pyetje pasi që disa persona që janë në list unë i njoh dhe kanë thënë se nuk kan perfituar ndersa në list e kan emrin si perfitues, du ta di se a është e vertet kjo.

Sami Vllasaliu tha: me pergjegjësi të plot them se prej vitit 2017 kur kam marr këtë detyr se procesi rrjedhe kështu, personat që janë të kthyer sigurisht se kanë një dokument që kanë qendruar atje dhe nese ka qenë me familje sigurisht se në raport do të regjistrohet si familje dhe në bazë të dokumentacioneve ne e vendosim në sistem, i gjithë dokumentacioni skenohet dhe regjistrohet në sistem.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet kjo pikë njëzëri nga të gjithë antarët prezant të Kuvendit me 12 vota gjithësëj dhe miret ky:

VENDIM

**APROVOHET** vendimi për planin komunal për riatdhesim.

**Pika e pestë:** Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: po nderlidhem me një shqetësim të një banori të fshatit Pasjak i cili është i dëmtuar në vitin 2017 nga fatkeqësit natyrore, është një pjesë e buxhetit për material ndertimor andaj kerkoi nga Kryetari që t'ja ndaj një shumë sipas vlerësimit që ka bërë komisioni. Ai qytetar ka qenë disa herë në Komunë dhe ka kerkuar që të lirohet nga tatimi në pronë por një gjë e tillë është e pamundshme por ka mundësi që Kryetari tja bëjë kompenzimin nga ai fond i caktuar për material ndertimor dhe kerkoi që të hedhet në votim ky propozim.

Ramush Mehmeti tha: ky problem ka qenë i kahershëm dhe ka dëmtuar shumë banorë kjo fatkeqësi natyrore, pasi që nuk ka mundësi që të lirohet nga tatimi në pronë por ka mundësi që të ndihmohet me material kerkoi që ta votojm këtë rekomandim që Kuvendi Komunal rekomandon Kryetarit që të ndihmohet ky qytetar nga kodi buxhetor material ndertimor, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: për sqarim ky qytetar e ka emrin Shaban Behluli.

Kryesuesi tha: kush është që ne si Kuvend ti rekomandojm Kryetarit që ta ndahet material ndertimor për Shaban Behlulin?.

Me 10 vota për 2 apstenime nga antarët prezent të Kuvendit aprovohet ky:

**S Y G J E R I M**

I sygjerohet Kryetarit të Kshillit Egzekutiv z.Svetislav Ivanvicit, që qytetarit z.Shaban Behluli nga fshati Pasjak, Komuna e Novobërdës, ti ndahet / ndihmohet me Material Ndërtimorë në vlerën e caktuar nga Komisioni për vlersimin e dëmeve.

Kryesuesi tha: pasi që po afrohet festa e 8 marsit, këtë viti 8 marsi është në diten e diel a keni ndonjë propozim se si ta festojm?.

Mirjana Simijonovic tha: 8 marsi është dita kur femrat kanë luftuar për të drejtat e tyre dhe kerkoi që të gjithë të jemi në një drek të përbashkët në diten e premte.

Ramush Mehmeti tha: përveq drekes propozoj që të ndahet edhe nga një shumë prej 50€ për koleget dhe asistenten e Kuvendit, një dhurat simbolike.

Zymer Zymeri pasi pershendetë të pranishmit tha: unë nuk e kuptova se ky propozim a është për të gjitha femrat në Komunën e Novobërdës apo vetem për Kuvend?.

Mirjana Simijonovic tha: vetem per Kuvend.

Zymer Zymeri tha: unë e perkrahi Ramushin dhe jo ka 50€ por ka 100€ tju ndahen antareve të Kuvendit dhe asistentes.

Abdyl Gashi tha: kjo ide nuk është e mirë për arsyse se ne mundë të dhëjmë propozime të ndryshme dhe një prej propozimeve që kisha dhënë është që të ndahet një shumë prej 500-1000€ e të shikojm se qendra sociale nënët që jetojn në gjendje të mjerueshme bashkarisht me asmblesitet tona ti vizitojm dhe tju bëjëm dhurat, nuk është kjo gjë e mirë që çdo mundësi që e kemi ta shfrytëzojm për veti. Mos të dhëjm shembull se të gjitha festat i shfrytëzojm vetem për veten tonë e nuk mendojm asnjëher për qytetarët e varfér.

Dobrivoje Djordjevic tha: nese e vendosni për të premten unë nuk mundë të vij.

Ramush Mehmeti tha: lejohet një dhurat për çdo festë i kemi 5 kolege dhe asistenten, nuk është shumë e madhe dhe kerkoi që të bihet vendimi në Kuvend që të jetë zyrtare.

Kryesuesi tha: nuk e di a kemi të drejt ti blejm këto dhurata.

## Procesverbali i Kuvendit

Ramush Mehmeti tha: kemi të drejt që Kuvend Komunal të marrë vendim për një drek solemne dhe për antaret e Kuvendit dhe asistenten të ndahet një shumë simbolike në vlerë 50€.

Jahi Zeqiri tha: unë propozoj pasi që jemi 15 antarë të Kuvendit 10 meshkuj e 5 fmenra ne meshkujt ti ndajm 300€ per koleget.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesusi e hudhi në votim propozimin e Ramush Mehmetit për ndarje të dhuratave për festen e 8 marsit.

Me 7 vota për, 3 kunder aprovohet ky propozim dhe bihet ky:

### VENDIM

**Aprovohet** vendimi për furnizim me dhurata për ndarje të 8. Marsit ditës ndërkombtare të gruas.

Ramush Mehmeti tha: në piken të ndryshme e kam edhe një propozim tjeter, nuk e di deri kur nuk do të rregullohet bina qe antarët e Kuvendit të dalin të folin, kemi buxhet dhe mundë të rregullohet dhe e dyta po dyshoj se nuk është duke e bërë monitorimin MAPL ndërsa është obligative që ta bëjë monitorimin e Kuvendit.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:40.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic

Kryesues i Kuvendit